

## Kushtet e përgjithshme për lëshimin dhe përdorimin e kartave të kreditit Visa Corporate

**Vërejtje:** Ky dokument është i vlefshëm vetëm nëse është përgatitur dhe nënshkruar në gjuhën maqedonase. Përkthimi i autorizuar në gjuhën shqipe shërben vetëm për ta kuptuar më mirë atë.

Kushtet e përgjithshme për lëshimin dhe përdorimin e kartave të kreditit Visa Corporate.

### 1. Përkufizimet

- Banka – S[ { ^!&@# } Banka AD [ ] ;
- Kartë – Kartë krediti Visa Corporate, të cilën Banka ia lëshon Përdoruesit të kartës në bazë të kërkesës së dorëzuar nga Aplikuesi-person juridik;
- Aplikuesi – person juridik i përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, i cili dorëzon kërkesë për lëshimin e kartës së kreditit Visa Corporate;
- Përdoruesi i kartës – person fizik, të cilit banka i lëshon kartë Visa Corporate, në emër të personit juridik me emër dhe mbiemër të përdoruesit të shtypur në kartë, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor;
- Llogaria në denarë - llogaria në denarë e Aplikuesit e hapur në Bankë, e cila ngarkohet/miratohet për shumën e transaksioneve, shpenzimeve, kompensimeve dhe normave të interesit, të cilat ndodhin me përdorimin e kartave në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj;
- Pagesë - pagesa në llogarinë në denarë për balancën e saldove negative në përputhje me kushtet e theksuara në Marrëveshje;
- Saldo e disponueshme e llogarisë në denarë – mjetet e disponueshme (mjetet vetanake dhe mjetet nga limiti kreditor i miratuar në MKD) të zvogëluara për mjetet e rezervuara dhe autorizuara, por që janë transaksione të pa arkëtuara;
- Limiti ditor - shuma e mjeteve, numri i transaksioneve dhe shuma maksimale e transaksioneve, të cilat Përdoruesi i kartës mund t'i përdorë në interval kohor ditor në tregti ose në para të gatshme;
- Shpenzime - të gjitha huamarrjet për shumën e transaksioneve, shpenzimeve, anëtarësive, kompensimeve dhe normave të interesit, të cilat ndodhin me përdorimin e kartës;
- Bankomati- pajisje elektronike, e cila mundëson pagesën e parave të gatshme, por edhe shërbime të tjera praninë e të punësuarve të Bankës;
- Pikë shitjeje – tregtar, i cili ka të lidhur Marrëveshje për shitjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë nëpërmjet kartave të programit të Visa International;
- POS - (Point of sale), terminal - pajisje elektronike e instaluar në pikat e shitjes ose në sportele bankare, që shërben për realizimin elektronik të transaksioneve;
- IM PRINTER- pajisje doze e instaluar në pikat e shitjes, që shërben për realizimin e transaksioneve;
- PIN - (Personal Identification Number), numër personal i fshehtë identifikimi i Përdoruesit të kartës, që shërben për identifikim gjatë përdorimit të kartës së bankomatit dhe terminalit POS;
- Dita e punës - Çdo ditë në të cilën Banka dhe institucionet financiare në Republikën e Maqedonisë kryejnë operacione financiare;

- Termat e lartpërmendur të përdorur në shumës, mund të përdoren edhe në njëjës dhe në trajtën e shquar duke mos e humbur kuptimin e definuar.

## 2. Lëshimi i kartës Visa Corporate

- Kërkesë për lëshimin e kartës Visa Business dorëzon përfaqësuesi ligjor i Aplikuesit. Përfaqësuesi ligjor i Aplikuesit, në emër dhe në llogari të Aplikuesit të kartës Visa Corporate garanton saktësinë e informatave të dhëna në Kërkesë. Aplikuesi i pranon rregullat e punës me kartën Visa Business dhe e merr përgjegjësi ndaj detyrimeve, që dalin gjatë përdorimit të kartës;
- Aplikuesi mund të kërkojë lëshimin e kartës Visa Corporate për më shumë përdorues;
- Pas marrjes së kartës, Përdoruesi është i detyruar ta nënshkruajë kartën dhe nënshkrimi të jetë identik me nënshkrimin në Kërkesë dhe pasaportë. Në rast të mosnënshkrimit të kartës nga ana e përdoruesit, Aplikuesi dhe përdoruesi i kartës barantin të ërë r rezikun e pasojave. Karta e panënshkruar nuk është e vlefshme;
- Kartat dhe numrat personal identifikues i merr personalisht Përdoruesi i kartës ose personi i autorizuar, duke treguar autorizimin e shkruar nga ana e Aplikuesit të kartës Visa Corporate;
- Afati i vlefshmërisë së kartës është i shënuar në kartë. Përdoruesi mund ta përdorë kartën vetëm për periudhën e afatizuar;
- Për të gjitha shpenzimet që dalin me përdorimin e kartës ngarkohet llogaria në denarë, përkatësisht llogaria në valutë e Aplikuesit të kartës. Aplikuesi i kartës Visa Corporate mund të ndërpresë të drejtën e përdorimit të kartës dhe për këtë është i detyruar me shkrim ta njoftojë Bankën dhe ta kthejë kartën e përdoruesit të copëtuar. Në rastet kur Aplikuesi nuk mund të arrijë ta posedojë kartën, procedura për ndërprerjen e të drejtës së përdorimit, realizohet nëpërmjet kërkesës me shkrim, ku karta bllokohet dhe pamundësohet përdorimi i mëtejshëm i saj.

## 3. Përdorimi i kartës në aktivitete përlllogaritjeje - pagesore

- Përdoruesi mund ta shfrytëzojë kartën për pagesa para të gatshme për prardhime dhe shërbime në të gjitha pikat e shitjes, ku ka të shënuar shenjën Visa në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj;
- Karta mund të përdoret edhe për tërheqjen e parave të gatshme në të gjitha bankomatet dhe bankat në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj, ku kanë të shënuar shenjën Visa;
- Përdorimi i kartës jashtë vendit bie nën juridiksionin e Ligjit për punë valutore dhe rregullave të tjera, që rregullojnë punën me valuta;
- Karta nuk mund t'iu bartet personave të tjerë dhe duhet të përdoret vetëm nga Përdoruesi i kartës emri i të cilit është i shtypur në të;
- Për të bërë pagesën e mallrave dhe shërbimeve, si dhe tërheqjen e parave të gatshme nga sportelet, Përdoruesi i kartës duhet të nënshkruajë një vërtetim (slip), në vend të transaksionit, ku nënshkrimi duhet të jetë i njëjtë me atë në kartë. Përdoruesi me vete mban një kopje të vërtetimit (slip) për evidencë. Për të gjitha parregullsitë gjatë realizimit të transaksionit, përdoruesi konteston në vendin e ngjarjes gjatë blerjes, përkatësisht gjatë shfrytëzimit të shërbimit;
- Përdoruesi është i detyruar, që t'i ruajë të gjitha dokumentet që lidhen me pagesat e bëra me kartë më së paku 6 muaj. Gjatë kërkesës së Bankës, ai duhet që të njëjtat t'i sigurojë dhe t'ia dorëzojë Bankës;

- Përdoruesi i kartës është i detyruar, që me kërkesë të shitësit të mallit, përkatësisht kryerësit të detyrës, të legjitimohet me letërnjoftim, përkatësisht me pasaportë;

- Për vërtetimin e identitetit të Përdoruesit të kartës, gjatë tërheqjes së parave të gatshme nga bankomati, përdoruesi përdorë numër të veçantë personal të identifikimit (PIN), i cili është unik dhe i fshehtë. Numrin personal identifikues, Banka ia ndanë Përdoruesit gjatë lëshimit të kartës. PIN-i është i njohur vetëm nga ana e Përdoruesit të kartës dhe me të njëjtin duhet të sillen si informatë konfidenciale, duke mos ua bërë të njohur për sonave të tjerë. PIN-i nuk duhet të shkruhet në kartë apo formë tjetër të shkruar, që do ta vinte në pikëpyetje sigurinë e kartës;

- Në rast të humbjes së PIN-it, Përdoruesi menjëherë duhet të drejtohet tek banka për lëshimin e PIN-it të ri;

- Përdorimi i kartës bëhet në kuadër të bilancit të lejuar të llogarisë, përkatësisht në kuadër të limitit ditor. Përdoruesi nuk guxon ta tejkalojë limitin kreditor dhe atë ditor të kartës.

#### **4. Kompensimet dhe normat e interesit**

- Të gjitha kompensimet, provizionet dhe normat që lidhen me kartën janë përcaktuar me Vendimin për tarifën e kompensimeve dhe Vendimin për normat e interesit të Bankës. Të njëjtat janë të ndryshueshme, varësisht nga politika afariste e Bankës dhe janë në dispozicion në uebfaqen dhe sportelet e Bankës;

- Për shumën e kompensimeve të llogaritura, provizionet dhe normat e interesit ngarkohet llogaria e Aplikuesit të kartës.

#### **5. Lajmërimi i përdoruesit**

- Lidhur me ndryshimet e llogarisë, si dhe për të gjitha ndryshimet që lidhen me punën me kartë, banka e lajmëron përdoruesin nëpërmjet raportit mujor, të cilin ia dërgon me postë.

#### **6. Humbja e kartës**

- Aplikuesi i kartës i bar të të gjitha pasojat e gjigjore dhe përgjegjësitë gjatë përdorimit të kartës paautorizuar të kartës;

- Përdoruesi është i detyruar që t'u përmbahet me asave të sigurisë gjatë përdorimit të kartës (duhet ta nënshkruajë kartën, ta mbajë PIN-in në fshehtësi dhe ndarazi nga karta, etj.);

- Përdoruesi i kartës obligohet që menjëherë ta lajmërojë humbjen, përkatësisht vjedhjen e kartës në Bankë, në telefonin 02 31 07-310 dhe këtë ta vërtetojë menjëherë edhe me dorëzimin e lajmërimit me shkrim deri te Qendra e Bankës – Shërbimi i kartave bankare apo në njësitë tjera organizative të Bankës – degë dhe filiale;

- Në rast të humbjes apo vjedhjes së kartës, Aplikuesi bartë përgjegjësi financiare për harxhimet e bëra me kartë në periudhën deri në 5 orë, pas lajmërimit paraprak për humbjen apo vjedhjen e saj;

- Nëse Përdoruesi i kartës, nuk e rrespekton detyrimin e fshehtësisë, ose e nuk i u përmbahet masave të sigurisë gjatë përdorimit të kartës, Aplikuesi, përkatësisht përdoruesi i bartë të gjitha përgjegjësitë për keqpërdorimin e të njëjtës;

- Pas pranimit të lajmërimit me shkrim për humbjen apo vjedhjen e kartës, Banka do t'i lëshojë kartë të re përdoruesit të saj. Shpenzimet rreth lajmërimit të humbjes/vjedhjes së kartës, lëshimit të kartës së re për shkak të dëmtimit të të njëjtës, ose dhënies së PIN-it pas humbjes apo vjedhjes, bien në llogarinë e Aplikuesit të kartës, në përputhje me Vendimin për Tarifave të kompensimeve të Bankës;

- Në rast se Përdoruesi e gjen kartën pas lajmërimit se e njëjta është e humbur, apo e vjedhur, nuk lejohet ta përdorë, por të njëjtën të coptuar duhet ta dorëzojë tek Banka. Shpenzimet e bëra gjatë përdorimit të kartës së gjetur të pavlefshme, arkëtohen në kurriz të llogarisë së Aplikuesit të kartës.

## **7. Reklamacioni**

- Banka nuk merr asnjë lloj përgjegjësie për cilësinë dhe sasinë e prapodhimeve, përkatësisht shërbimeve të blera me kartë;

- Reklamacionet lidhur me cilësinë dhe sasinë e prapodhimeve, përkatësisht shërbimeve të blera me kartë zgjidhen në pikën e shitjes.

- Aplikuesi është i detyruar t'i paguajë të gjitha shpenzimet sipas llogarisë, pa marrë parasysh reklamacionet;

- Në rast se Aplikuesi i kartës vlerëson se dështon shpenzimet janë llogaritur dhe arkituar gabimisht, ose nuk i takojnë, mund t'i drejtohet Bankës, duke i dorëzuar llogaritë dhe të gjitha dokumentet tjera relevante që Banka mund t'i kërkojë;

- Reklamacionet dorëzohen duke plotësuar formularin e Bankës në sportelet e saj të shënuara për pranimin e reklamacioneve për kartën ose deri të Shërbimi për karta bankare;

- Afati i dorëzimit të reklamacioneve është deri 20 (njëzet) ditë pas përfundimit të muajit që kur është arkëtuar transaksioni. Në të kundërtën, Banka vlerëson se Aplikuesi i kartës pajtohet me shpenzimet e përgjithshme të theksuara në Raport;

- Nëse Banka vërteton se reklamacioni është i arsyeshëm do ta miratojë llogarinë e Aplikuesit të kartës, por në rast të reklamacioneve të paarsyeshme, Aplikuesi i bartë të gjitha shpenzimet, të cilat dalin nga procedura e reklamacionit, si kompensim në përputhje me Vendimin e Tarifave për kompensim për shërbimet e Bankës;

- Afatin e zgjidhjes së rastit të reklamacionit e përcakton Banka në përputhje me rregulloret e Visa International.

## **8. Dispozitat tjera**

- Dispozitat kanë të bëjnë me Aplikuesin e kartës Visa Corporate, si dhe me çdonjërin Përdorues të kartës;
- Banka nuk bartë asnjë lloj përgjegjësie nëse Përdoruesi i kartës nuk mund ta përdorë kartën në situatat vijuese, të cilat janë jashtë kontrollit të Bankës:
  - probleme teknike me pajisjet, sistemin, telekomunikimin dhe rrymën;
  - grevë, ose rrethana të tjera të jashtëzakonshme;
  - në rast se karta është robëruar në pikat e shitjes, a po në bankomat dhe e njëjta është e dëmtuar;
  - në rastet kur për çfarëdolloj shkak, pika e shitjes, banka apo bankomati nuk e pranon kartën;
- Banka e ruan të drejtën e ndërrimit të rregullave dhe kushteve të punës me kartë, si dhe Tarifave për kompensim të shërbimeve të Bankës Komerciale SHA dhe Vendimit për normat e interesit të Bankës Komerciale SHA në përputhje me politikën afariste të Bankës dhe për këto ndryshime apo plotësime do ta lajmërojë Aplikuesin nëpërmjet ueb faqes së bankës po Raportet për llogarinë në denarë;
- Çdo përdorim i kartës në kundërshtim me rregullat ligjore, si dhe pa gesa e mallrave dhe/ose shërbimeve, të cilat janë të ndaluara me ligj dhe të dënueshme;
- Çdo përdorim i kartës në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura tërheq veprime të marrjes së kartës, marrjen e masave në përputhje me Dispozitat ligjore, kurse gjithë dëmin material së bashku me normat e interesit i bartë Aplikuesi i kartës Visa Corporate;
- Me nënshkrimin e Aplikimit, Përdoruesi i kartës vërteton se është i njohur më Kushtet e Përgjithshme dhe se në tërësi pajtohet me to dhe me veprimet juridike, të cilat dalin prej tyre.